

VENDIM
Nr. 548, datë 18.6.2015

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 381, DATË 8.4.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR REGJISTRIMIN E DISENJOVE INDUSTRIALE””

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 181 e 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 381, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 1 shtohen pikat 1.1 dhe 1.2, me këtë përmbajtje:

“1.1. Në të gjithë formularët e disenjove industriale, para rubrikës “Nënshkrimi i aplikantit ose përfaqësuesit të tij” shtohet rubrika me tekstin e mëposhtëm:

Megenëse DPPM-ja posedon të dhënat e mia, të cilat sipas ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, përkufizohen si “të dhëna personale”, të cilat i kam dhënë personalisht me qëllim përfitimin e shërbimeve të ofruara, jap miratimin për përpunimin e të dhënave, në funksion të shërbimeve të kërkuara nga unë apo nga DPPM-ja, nëpërmjet komunikimit me letra, telefon, SMS, internet apo formave të tjera të komunikimit.

DPPM-ja merr përsipër përgjegjësinë që ky informacion do të mbrohet dhe do të trajtohet sipas legjislacionit në fuqi.

1.2. Në të gjithë formularët e disenjove industriale logoja dhe adresa e zyrës të vendosen sipas vendit ku DPPM-ja do të ushtrojë aktivitetin e saj.”.

2. Në rregulloren “Për regjistrimin e disenjove industriale”, që i bashkëlidhet vendimit, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 2, 3, 4 dhe 5, të kreut II, “Paraqitja e kërkesës për regjistrimin e disenjove industriale”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Data e depozitimit dhe kërkesat formale për aplikim

2.1. Datë e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e një disenjeje vlerësohet data kur DPPM-ja merr në dorëzim aplikimin, i cili përmban elementet e mëposhtme:

- a) Kërkesën për regjistrim;
- b) Identitetin e aplikuesit;
- c) Përfaqësimin e disenjës së përshtatshme për riprodhim;
- ç) Vërtetim të pagesës së tarifës së depozitimit.

2.2. Dy ose më shumë disenjo mund të jenë objekt i të njëjtit aplikim, me kusht që ato t’i përkasin së njëjtës klasë, në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Disenjove (Locarno).

2.3. Aplikimi për regjistrimin e një disenjeje përmban edhe këto elemente:

- a) Emrin dhe adresën e aplikuesit;
- b) Emrin dhe adresën e përfaqësuesit, si dhe autorizimin e përfaqësimit;
- c) Treguesin e produktit në të cilin është e përfshirë disenjoja ose mbi të cilin ajo do të aplikohet;
- ç) Përshkrimin e disenjës;
- d) Kopjen e përfaqësimit të disenjës, në përputhje me kërkesat e rregullores përkatëse;
- dh) Klasifikimin e produkteve, në të cilat disenjoja është e përfshirë ose mbi të cilat do të aplikohet, sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Disenjove (Locarno);
- e) Identitetin e krijuesit ose të krijuesve të disenjës dhe një deklaratën që autorizon aplikuesin ta

regjistrojë disenjon kur aplikuesi nuk është krijuesi;

ë) Nënshkrimin e aplikuesit ose të përfaqësuesit të tij.

3. Paraqitja e disenjos përbëhet nga riprodhimi grafik ose fotografik i disenjos, i cili duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

a) Riprodhimi i disenjos duhet të jetë i qartë, pa korrigjime, i vendosur mbi një sfond neutral dhe të ketë një cilësi të tillë që lejon të dallohen qartë të gjitha elementet e disenjos për të cilat kërkohet mbrojtja;

b) Riprodhimi i disenjos duhet të depozitohet së bashku me aplikimin, duke u ngjitur ose printuar mbi një fletë të bardhë format A4. Mbi këtë fletë nuk duhet të vendosen tekste shpje-guese, shkronja apo simbole, përveç një treguesi në kreun e fletës, kur është e nevojshme;

c) Madhësia e riprodhimit të disenjos, të vendosur mbi fletën e bardhë format A4, duhet të jetë në përmasa jo më të mëdha se 26,2 cm x 17 cm;

ç) Paraqitja e disenjos duhet të përmbajë jo më shumë se shtatë pamje të ndryshme të disenjos, njëra prej të cilave duhet të jetë pamja e përgjithshme e saj;

d) Aplikanti duhet t'i vendosë një numër rendor secilës prej pamjeve të disenjos. Në rastin e aplikimeve për diseno të shumëfishta, për secilën pamje duhet të vendoset numri rendor, i cili përbëhet nga numri i disenjos dhe më pas numri i pamjes, të ndara mes tyre me një pikë;

dh) Çdo riprodhim grafik ose fotografik i disenjos mund të përmbajë vetëm një pamje të disenjos;

e) Në rast se aplikanti depoziton më shumë se shtatë pamje të ndryshme të disenjos, DPPM-ja merr në konsideratë, për efekt të publikimit dhe regjistrimit, vetëm shtatë pamjet e para, sipas numrit rendor që u është vendosur pamjeve nga aplikanti.

3.1. Përshkrimi i disenjos duhet të ketë jo më shumë se 100 fjalë dhe duhet t'i referohet vetëm atyre elementeve të disenjos që janë të dukshme në riprodhimin e saj. Përshkrimi nuk duhet të përmbajë deklarata lidhur me karakterin individual apo risinë e disenjos.

3.2. Në rastin e disenjove të shumëfishta, aplikanti, për secilën nga disenjot që përmban aplikimi, duhet të depozitojë përfaqësimin e disenjos në përputhje me kërkesat e pikës 2.2, të këtij kreu, përshkrimin e saj si dhe produktin ku do të aplikohet disenjoja ose me të cilin do të bashkohet ajo. Secila nga disenjot e një aplikimi për diseno të shumëfishtë duhet të numërohet sipas rendit numerik arab.

4. Të dhëna dhe dokumente shtesë që duhet të përmbajë aplikimi

4.1. Në përputhje me nenin 119, të ligjit, kërkesa për regjistrimin e disenjos duhet të përmbajë edhe:

a) deklaratën e krijuesit ose krijuesve, në të cilën të shprehet vullneti për regjistrimin e disenjos në emrin e aplikantit. Deklarata e krijuesit duhet të bëhet me akt noterial;

b) autorizimin e përfaqësimit, kur aplikimi depozitohet nga përfaqësuesi i aplikantit.

Autorizimi i përfaqësimit duhet të përmbajë nënshkrimin e aplikantit dhe, kur aplikanti është person juridik, edhe vulën e tij;

c) një skemë të përgatitur, projekte ose një model të produktit, nëse është e nevojshme për të sqaruar thelbin e disenjos.

5. Depozitimi i dokumentit të prioritetit

5.1. Në rast se kërkohet prioritet, aplikanti duhet që, brenda 3 (tre) muajve nga data e paraqitjes së kërkesës, të depozitojë pranë DPPM-së dokumentin e prioritetit, në bazë të pikës 4, të nenit 119, të ligjit, ose certifikatën e lëshuar nga autoritetet kompetente të ekspozitës ku është paraqitur produkti, në bazë të nenit 120, të ligjit. Në të kundërt e drejta e prioritetit humbet. Dokumenti i prioritetit, i depozituar në bazë të pikave 4 dhe 4a, të nenit 119, të ligjit, duhet të përmbajë datën e depozitimit, numrin e aplikimit të mëparshëm, zyrën ku është bërë aplikimi si dhe një kopje të vërtetuar të aplikimit të mëparshëm, paraqitjen e disenjos dhe produktin që përfaqëson disenjoja.

Dokumenti i prioritetit duhet të depozitohet i përkthyer në gjuhën shqipe dhe i noterizuar.

Për qëllim të nenit 113, e drejta e prioritetit, e fituar si më sipër, sjell pasojë që data e prioritetit të quhet si datë depozitimi e disenjos së regjistruar pranë DPPM-së.

5.2. E drejta e prioritetit, e fituar në bazë të parashikimeve të ligjit dhe të kësaj rregulloreje, sjell si pasojë që data e prioritetit të quhet si datë depozitimi e aplikimit për një diseno të regjistruar pranë DPPM-së, vetëm për efekt të përcaktimit se cili aplikim gëzon një të drejtë të mëparshme.”.

b) Kreu III dhe kreu IV riformulohen, si më poshtë vijon:

“Kreu III

Ekzaminimi i kërkesave formale dhe ekzaminimi i arsyeve absolute për refuzim

1. Rendi i ekzaminimit të aplikimit

1.1 Kërkesat për regjistrim disenjoje ekzaminohen sipas numrit rendor të tyre. Një kërkesë ekzaminohet jashtë radhës përjashtimisht vetëm nëse ekziston një konflikt rreth shkeljes të të drejtave të disenjos, ose është depozituar një kërkesë për regjistrimin ndërkombëtar të disenjos.

Ekzaminimi jashtë radhës bëhet nga ekzaminuesi, pasi aplikanti të paraqesë një kërkesë me shkrim dhe të paguajë tarifën për-katëse.

2. Ekzaminimi i kërkesave formale

2.1. DPPM-ja, brenda tre muajve nga data e marrjes së aplikimit për regjistrimin e një disenjoje, kryen një ekzaminim paraprak për të përcaktuar datën e depozitimit të aplikimit. Nëse aplikimi është në përputhje me kërkesat e pikës 1, të nenit 119, të këtij ligji, data e depozitimit të aplikimit është data e dorëzimit të aplikimit pranë DPPM-së, në të kundërt data e depozitimit të aplikimit është data, në të cilën plotësohen kërkesat e pikës 1, të neni 119.

2.2. Brenda një periudhe tremujore, DPPM-ja shqyrton aplikimin për përmbushjen e kërkesave formale të nenit 119, të këtij ligji, si dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe, sipas rastit, lëshon dëshminë e depozitimit. Kur aplikimi nuk përmbush të gjitha kërkesat formale të nenit të lartpërmendur, si dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, DPPM-ja njofton aplikuesin për t'i plotësuar ato brenda tre muajve nga data e njoftimit. Nëse aplikuesi plotëson aplikimin brenda afatit, DPPM-ja lëshon dëshminë e depozitimit, duke njohur si datë depozitimi të aplikimit:

a) datën e paraqitjes së aplikimit pranë DPPM;

b) datën e plotësimit të të metave të kërkesës,

në të kundërt, e refuzon aplikimin dhe njofton për këtë me shkrim aplikuesin.

Në rastin kur të metat e kërkesës lidhur me ndonjë prej elementeve konsistojnë në gabime të tilla që nuk cenojnë thelbin e këtyre elementeve, si datë depozitimi e kërkesës do të njihet data në të cilën aplikimi është paraqitur pranë DPPM-së.

Periudha për paraqitjen e plotësimeve mund të zgjatet deri në një muaj shtesë, nëse aplikuesi paraqet kërkesë me shkrim dhe paguan tarifën e përcaktuar në rregulloren përkatëse.

3. Ekzaminimi i arsyeve absolute për refuzim

3.1. DPPM-ja, brenda tre muajve nga data e depozitimit të aplikimit për regjistrimin e një disenjoje, ekzaminon nëse disenjoja, përveç përmbushjes së kërkesave formale, është në përputhje edhe me kërkesat e nenit 115, të këtij ligji.

3.2. Nëse disenjoja nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 115, të këtij ligji, DPPM-ja njofton aplikuesin dhe i jep atij mundësinë të parashtrojë, brenda dy muajve nga data e njoftimit, vërejtjet dhe shpjegimet e tij ose të depozitojë dokumente shtesë.

3.3 Aplikimi refuzohet nëse aplikuesi nuk parashtron vërejtjet e tij apo nuk depoziton dokumentet shtesë të kërkuara brenda afatit kohor ose nëse DPPM-ja vëren se aplikimi nuk është në përputhje me nenin 115 edhe pas përgjigjes së aplikuesit. Ky vendim i njoftohet aplikuesit. Vendimi

për refuzimin e disenjës, bazuar mbi arsye absolute refuzimi, merret nga DPPM-ja vetëm pasi është marrë vendimi mbi kërkesat formale.

4. Dëshmia e depozitimit

4.1 Dëshmia e depozitimit përmban të dhënat e mëposhtme:

- a) Datën dhe numrin e depozitimit;
- b) Emrin dhe adresën e aplikantit;
- c) Emrin dhe adresën e krijuesit të disenjës, përveç kur krijuesi ka kërkuar që emri i tij të mos përmendet;
- ç) Produktin që përfaqëson disenjoja, si dhe klasën e nënklasën e produktit, në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Disenjave (Locarno);
- d) Të dhënat e prioritetit (nëse ka);
- dh) Numrin e disenjave të përfshira në aplikim në rastin e disenjave të shumëfishta.

5. Publikimi i disenjës

DPPM-ja publikon të dhënat e aplikimit në buletin e saj nëse është lëshuar dëshmia e depozitimit dhe disenjoja është në përputhje me kërkesat e nenit 115 të ligjit.

5.1 Në të dhënat, që publikohen në buletin për aplikimet për regjistrimin e disenjave, përfshihen:

- a) emri dhe adresa e aplikantit;
- b) numri i kërkesës dhe data e depozitimit;
- c) emri dhe adresa e krijuesit të disenjës, përveç kur krijuesi, me anë të një deklaratë me shkrim, ka kërkuar që emri i tij të mos përmendet;

ç) pamjet e disenjës;

d) produkti që përfaqëson disenjoja si dhe klasa e nënklasa e produktit në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Disenjave (Locarno);

dh) të dhënat e prioritetit (nëse ka);

e) numri i disenjave të përfshira në aplikim në rastin e disenjave të shumëfishta.

5.2. Në të dhënat, që publikohen në buletin për disenjtë e regjistruara, përfshihen:

- a) emri dhe adresa e pronarit të disenjës së regjistruar;
- b) numri i kërkesës dhe numri i regjistrimit të disenjës;
- c) data e depozitimit, data e mbarimit të mbrojtjes, data e regjistrimit, si dhe data e prioritetit (nëse ka);

ç) produkti që përfaqëson disenjoja, si dhe klasa e nënklasa e produktit, në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Disenjave (Locarno);

d) emri dhe adresa e krijuesit të disenjës, përveç kur krijuesi, me anë të një deklaratë me shkrim, ka kërkuar që emri i tij të mos përmendet;

dh) numri i disenjave të përfshira në regjistrim në rastin e disenjave të shumëfishta.

5.3 Nëse aplikanti, së bashku me aplikimin, ka paraqitur një kërkesë me shkrim për shtyrjen e publikimit të disenjës dhe ka paguar tarifën përkatëse, DPPM-ja e publikon disenjon në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit 122, të ligjit.

Kreu IV

Regjistrimi i disenjës industriale

1. Regjistrimi i disenjës

1.1 DPPM-ja njofton aplikuesin të paguajë tarifën e regjistrimit pas kalimit të afatit 3-mujor nga data e publikimit të disenjës, nëse nuk janë depozituar kundërshtime apo kundërshtimet janë refuzuar. Aplikuesi paguan tarifën e regjistrimit brenda një muaji nga data e njoftimit nga DPPM-ja. DPPM-ja regjistron disenjon në regjistrin e disenjave dhe lëshon certifikatën e regjistrimit brenda tre muajve nga data e kryerjes së pagesës nga aplikuesi.

1.2 Nëse aplikuesi nuk e paguan tarifën e regjistrimit brenda periudhës së caktuar, në pikën 1, të këtij neni, DPPM-ja e refuzon aplikimin për regjistrimin e disenjos.

1.3 Disenjoja e regjistruar publikohet në buletin e DPPM-së.

2. Të dhënat që përmban certifikata e regjistrimit të disenjos

2.1. Certifikata e regjistrimit të disenjos duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e pronarit të disenjos së regjistruar;
b) numrin e kërkesës dhe numrin e regjistrimit të disenjos;
c) datën e depozitimit, datën e mbarimit të mbrojtjes, datën e regjistrimit, si dhe datën e prioritetit (nëse ka);

ç) produktin që përfaqëson disenjoja, si dhe klasën e nënklasën e produktit, në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar të Disenjove (Locarno);

d) pamjet e disenjos;

dh) datën e publikimit të disenjos;

e) numrin e disenjove të përfshira në regjistrim në rastin e disenjove të shumëfishta;

ë) emrin dhe adresën e krijuesit të disenjos, përveç kur krijuesi, me anë të një deklarate me shkrim, ka kërkuar që emri i tij të mos përmendet.

3. Kryerja e ndryshimeve ose heqja dorë nga aplikimi para regjistrimit të disenjos

3.1 Kur aplikimi për regjistrimin e një disenjoje është në proces ekzaminimi dhe ka ndodhur ndryshimi i emrit dhe/ose adresës së aplikantit apo aplikanti ia ka transferuar të drejtat mbi disenjon një pale tjetër, DPPM-ja, kundrejt depozitimit nga aplikanti të formularëve përkatës, të dokumenteve që provojnë ndryshimet e mësipërme dhe pagesës së tarifës përkatëse, e regjistron disenjon në regjistrin e disenjove me të dhënat e reja, pa ndryshuar datën e depozitimit të aplikimit.

3.2. Aplikanti mund të kërkojë, nëpërmjet një kërkeje me shkrim, korrigjimin e gabimeve ose pasaktësive që përmban aplikimi për regjistrimin e disenjos, kur këto kanë të bëjnë me emrin ose adresën e aplikantit, të krijuesit ose të përfaqësuesit të aplikantit apo të pasaktësive të tjera të cilat nuk cenojnë thelbin e elementeve të aplikimit, për aq kohë sa aplikimi nuk është regjistruar në regjistrin e disenjove.

3.3. Aplikanti ka të drejtë të heqë dorë nga aplikimi për regjistrimin e disenjos, nëpërmjet një kërkeje me shkrim, për aq kohë sa disenjoja nuk është regjistruar ende në regjistrin e disenjove. Me depozitimin e një kërkeje të tillë, aplikimi konsiderohet i tërhequr. Në rastin e disenjove të shumëfishta, aplikanti mund të heqë dorë nga disa prej disenjove për të cilat është bërë aplikimi ose nga i gjithë aplikimi.

3.4 Datë e regjistrimit të disenjos në regjistrin e disenjove quhet data e lëshimit të certifikatës së regjistrimit të disenjos nga DPPM-ja.

4. Ndarja e aplikimit për disenjo të shumë-fishtë

4.1. Në rastin e aplikimit për disenjo të shumë-fishtë, aplikanti mund të kërkojë ndarjen e aplikimit, duke depozituar pranë DPPM-së formularin FD10 dhe dokumentin e pagesës së tarifës përkatëse.

4.2. Aplikimet e ndara kanë të njëjtën datë depozitimi me aplikimin fillestar dhe trajtohen nga DPPM-ja si aplikime për disenjo të veçanta në përputhje me parashikimet e ligjit dhe të kësaj rregulloreje.

4.3. DPPM-ja mund t'i kërkojë aplikantit të bëjë ndarjen e aplikimit për disenjo të shumëfishtë, në rast se produktet ku do të aplikohen disenjoyt ose të cilave do t'u bashkohen ato, u përkasin klasave të ndryshme të Klasi-fikimit Ndërkombëtar të Disenjove (Locarno).

4.4. Aplikimi i ndarë përfiton të drejtën e prioritetit të aplikimit fillestar vetëm nëse e drejta për prioritet është kërkuar nga aplikanti në kërkesën për ndarjen e aplikimit dhe nëse prioriteti i aplikimit fillestar është i zbatueshëm për të.”.

c) Pika 1, e kreut V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Llojet e publikimeve

1.1. DPPM-ja, në zbatim të nenit 122 të ligjit, publikon në Buletinin e Pronësisë Industriale të dhënat mbi aplikimet për regjistrimin e disenjove. Në këtë buletin publikohen edhe të dhënat mbi regjistrimin e disenjove, ripërtëritjet, licencimin dhe transferimin e pronësisë së disenjove të regjistruara, ndryshimet në emrin, adresën e pronarit të disenjës, dorëheqjen dhe shfuqizimin e disenjove të regjistruara.

DPPM-ja publikon të dhënat e aplikimit në buletin e saj nëse është lëshuar dëshmia e depozitimit dhe disenjoja është në përputhje me kërkesat e nenit 115 të ligjit.”.

ç) Pika 1.2/c, e kreut IX, “Regjistrimi i kontratës së licencës”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) kontratën e licencës, e cila duhet të jetë në formën e një akti noterial.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama